



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.10.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.10.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIACION SHPK&NAZERI 200 SHPK DEGA NE KOSOVE" për aktivitetin: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekono"INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIACION SHPK&NAZERI 200 SHPK DEGA NE KOSOVE" e datës 15.10.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës " dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër *Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 10.10.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet Njoftimi i Autoritetit Kontraktues i publikuar me datë: 10.10.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj respektimin e Vendimit të datës 10.10.2019*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "" me datë 15.10.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës " dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.10.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara për arsye në vijim:

-Pretendimi i pare lidhur me OE-ik te propozuar per dhenje te kontrates eshte i pa qendrueshem pasi qe sipas LPP-ik dhe interpretimeve te KRPP-se qarkullimi bankar eshte nje nga format e ligjshme per te deshmuar kapacitetet ekonomike financiare;

-Pretendimi se OE-ik i rekomanduar per dhenje te kontrates nuk ploteson kriterin e vleres se referencave prej 3.000,000.00 euro poashtu nuk qendron pasiqe vetem njeri nga anetaret e grupit ka deshmi mbi kete vlere(Aulona Pol)dhe te njejtat jane te deshmuara me transakcione bankare,qe per AK-ne eshte deshmi e pranueshme;

-Pretendimet per shkeljen e nenit 7 po ashtu nuk qendron pasi qe eshte kerkuar nga te gjitha tenderuesit qe kane ofruar çmime te cilat nuk mbulojne kerkesat nga FDT-ja qe te dergojne sqarime lidhur me çmimet e tyre dhe te njejtat jane trajtuar duke u bazuar ne kerkesat nga Dosja e tenderit,respektivisht nga fakti se eshte kerkuar nga DT-ja dhe nga sqarimet e me vonshme se çdo tenderues duhet te ofroj çmim i cili mbulon te gjitha detyrimet financiare sipas Ligjit te Punes;

Pretendimi tjetër se nuk eshte kerkuar numri i punetoreve per kryerjen e sherbimeve poashtu eshte i pa bazuar,pasiqe edhe ne pershkrimet teknike edhe ne pershkrimin e çmimit jane paraqitur qarte numri i pozitivave dhe ne baze te kesaj eshte e lehte te percaktohet numri i punetoreve;dhe

Pretendimi per favorizim te tenderuesit tjetër nuk qendron,por arsyeja e rekomandimit qendron ne faktin se ka paraqitur analize te sakte financiare.

Bazuar ne analizat sipas kerkesave nga FDT dhe Pershkrimi i çmimeve eshte perpiluar analiza qe eshte ne Vendimin per refuzimin e rekomandimit te komisionit per vleresim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet detale nga Vendimi për refuzim te rekomandimit per kontrate ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit